


Mashtrimi i fëmijëve përmes internetit




Një ndër format më të reja të rekrutimit dhe mashtrimit të viktimave potenciale të trafikimit është përmes internetit dhe komunikimit nëpër rrjete sociale.

Të rinjtë mashtrohen me premtime për punë, si: modele ose punë të tjera atraktive, që kinse ju sjellin përfitime të mëdha, ndërsa përfundojnë në rrjet të trafikantëve dhe shfrytëzohen për punë ilegale...

Trafikimi si shkelje e të drejtave të fëmijëve

Kjo ndodh kur fëmijët detyrohen të dalin në rrugë dhe të punojnë si pastrues të xhamave të veturave nga ana dhe për përfitim të një personi të vetëm apo rrjetit të organizuar të trafikantëve.



RAPORTO!

Linja ndihmëse
0800 11 112
192


antitrafikimi@kosovopoliice.com



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

**TRAFIKIMI I PREKË TË GJITHË!
TA MBROJMË VETËN,
DHE FËMIJËT TANË!**

MOS HESHT!
PARANDALO TRAFIKIMIN ME NJEREZ!



Trafikimi me qenie njerëzore

Trafikimi fillon me mashtim dhe joshje për një jetë më të mirë...



...e që përfundon në shkelje të të drejtave themelore të njeriut e veçanërisht të fëmijëve...



Nëse jeni dëshmitarë të ndonjë shfrytëzimi që po i bëhet ndonjërit si formë e trafikimit ose jeni vet në kurth të trafikantëve, ju lutem raportoni në:

POLICI: 192

LINJËN NDIHMËSE: 0800 11 112
antitrafikimi@kosovopolice.com

Shfrytëzimi i fëmijëve për kërkim të lëmshës




Kjo ndodh kur fëmijët detyrohen të dalin në rrugë dhe të grumbullojnë të holla përmes kërimit nga ana dhe për përfitim të një personi të vetëm apo rrjetit të organizuar të trafikantëve.

Detyrimi dhe shfrytëzimi i fëmijëve për punë të rënda

Disa fëmijë shfrytëzohen për të kryer punë të ndryshme, e ndonjëherë edhe të rënda për moshën e tyre - ndërsa fëmijet nuk duhet të punojnë deri mbi moshën 15 vjeçare.

Shumë herë ndodh që ndonjë familjarë i largët ose edhe ndonjë rrjet i trafikantëve/kriminelëve i detyron fëmijët të bëjnë punë të ndryshme dhe të rënda fizike - në ç'rast konsiderohet si trafikim.



Trafikimi me qëllim të shfrytëzimit seksual



Kjo është forma më e shpeshtë e trafikimit, ku femrat, meshkujt dhe fëmijët detyrohen të ofrojnë shërbime seksuale me qëllim përfitimi të palëve të treta.

Trafikimi për shfrytëzim seksual fillon me rekrutim në formë joshjeje dhe premtime të rrejshme për një jetë më të mirë, punësim apo martesë.

Viktimat e kësaj forme të trafikimit përdoren dhe kontrollohen nga trafikantët.

Shfrytëzimi i fëmijëve për vepra kriminale

Kjo ndodh kur fëmijët detyrohen ose mashtrohen që ta kryejnë një krim të caktuar, si: vjedhje, shitje të substancave ilegale dhe të tjera.

Kjo është e levërdishme për trafikantët, sepse e dijnë që për ato krime, dënimet për fëmijë janë të ulëta.

